



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.Dh.Sh.II.nr.1190/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, me gjyqtarin individual Krenar Berisha, në çështjen përmbarimore të kreditorit Alim Sanayi Ticeret AS me seli në Turqi, të cilin me autorizim e përfaqëson Violeta Jashari avokate nga Prishtina, kundër debitorit Florent shpk me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1737/22 të datës 30.06.2023, me datën 02.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e debitorit Florent shpk me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1737/22 i datës 30.06.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Dhoma e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar, KPPP.nr.1737/22 të dt.30.06.2023, ka vendosur si në vijim: Hedhet si i pasafatshëm prapësimi i debitorit Florent shpk me seli në Prishtinë, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.068/22 i datës 02.03.2022 i lejuar nga Përmbaruesi Privat Rrezarta Metaj, dhe ka lën në fuqi Urdhrit përmbarimor P.nr.068/22 i datës 02.03.2022 i lejuar nga Përmbaruesi Privat Rrezarta Metaj,

Ankesë ka paraqitur në afat ligjor debitori, i cili në ankesë deklaroi se urdhri përmbarimor është pranuar me datën 23.02.2023, por ka mund të bëhet ndonjë gabim teknik qoftë drejtshkrimore nga ana e tij apo nga dërguesi. I propozojmë gjykatës që pas verifikimit të datës së pranimit dhe dorëzimit të vërtetohet saktë se prapësimi ka qenë i paraqitur në afatin ligjor, dhe propozon që gjykata të merr aktvendim me të cilin aprovon ankesën e debitorit, e prish aktvendimin e Dhomës së shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1737/22 i datës 30.06.2023, dhe të pranohet si i bazuar dhe i afatshëm prapësimi i debitorit i ushtruar kundër urdhrit përmbarimor P.nr.068/22.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për procedurën përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori Alim Sanayi Ticeret AS me seli në Turqi, me datën 15.02.2022 ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit Florent shpk me seli në Prishtinë, mbi bazën e faturave nr.718/2021 dt.20.05.2021 dhe nr.757/2021 datës 26.05.2021, në shumën prej 9,791.95€, si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Përmbaruesi Privat Rrezarta Metaj, me Urdhrin Përmbarimor P.nr.068/22 të datës 02.03.2022, ka lejuar përmbarimin, duke vlerësuar se dokumenti përmbarues fatura, i plotëson kushtet për përmbarim.

Kundër këtij urdhri përmbarimor, debitori ka paraqitur prapësim duke e kundërshtuar në tërsi urdhrin përmbarimor me arsyetimin se borxhi i kërkuar nga kreditori nuk është real dhe nuk përputhet me faturat e bashkangjitura, pasi që kreditori e ka ngarkuar të njëjtin borxh dy herë dhe se ka mospërputhje në mes faturave mes vete dhe kodeve, i propozon gjykatës që prapësimin ta aprovoj në tërsi si të bazuar ndërsa ta shfuqizoj urdhrin për lejimin e përmbarimit.

Kreditore në përgjigje në prapësim, deklaroi se prapësimi i debitorit është i pasafatshëm, pasi që është dorëzuar në ditën e 8 pas pranimit të urdhrin, andaj si i tillë duhet të hedhet poshtë, Ka shtuar se edhe sikur prapësimi të jetë i afatshëm, debitori me prapësim në asnjë paragraf të tij nuk e ka kontestuar borxhin.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1737/22 të datës 30.06.2023 e ka Hedh Poshtë si i pas afatshëm prapësimin e debitorit Florent shpk me seli në Prishtinë,, duke vendosur si në dispozitiv të aktvendimit.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, Dhoma e shkallës së parë, thekson se prapësimi i debitorit është i pa afatshëm duke u referuar në nenin 70 të LPP-së. Debitori e ka pranuar urdhrin përmbarimor me datën 22.02.2022 fakt ky që vërtetohet nga fletëkthesa e Postës së Kosovës, ndërsa debitori prapësimin e ka paraqit në zyrën e përmbaruesit privat me datën 02.03.2022, fakt ky që vërtetohet nga vula e pranimit të shkresave të përmbaruesit privat, dhe i cili fakt konstatohet nga vet përmbaruesi privat me konkluzionin e datës 04.03.2022.

Dhoma e shkallës së dytë e pranon si të rregullt dhe të ligjshëm aktvendimin e atakuar të Dhomës së shkallës së parë, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë nuk i ka pranuar pretendimet ankimore për ta ndryshuar aktvendimin e atakuar, pasi që Dhoma e shkallës së parë duke vlerësuar drejtë provat të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës të ofruara nga ndërgjyqësit, ka vendosur drejtë si në dispozitiv të aktvendimit, duke dhënë arsye përkatëse në pjesën arsyetuese të aktvendimit të atakuar dhe drejtë ka aplikuar edhe Ligjin e Procedurës Përmbarrimor përkatësisht nenin 70 të Ligjit nr. 04/L-139 i cili parasheh së *“Prapësimi duhet t’i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbarrues ose urdhrin përmbarrues”*, ndërsa me nenin 126, paragrafi 2 të Ligjit për procedurën kontestimore, përcaktohet se *“Në qofte se afati është caktuar me ditë, përjashtohet nga llogaritja dita në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të filloj afati, kështu që për fillim të afatit merret dita e parë e ardhshme”*. Prandaj, në rastin konkret rezulton se debitori urdhrin përmbarrimor e ka pranuar me datë 22.02.2022, ndërsa afati për paraqitjen e prapësimi ka filluar të rrjedhë nga data 23.02.2022, që rezulton se dita e fundit për paraqitjen e prapësimi ka qenë data 01.03.2022.

Andaj, Gjykata Komerciale, Dhomat e shkallës së dytë vlerësoi se meqë debitori prapësimin e ka paraqitur me datën 02.03.2022, e cila vërtetohet nga vula e pranimit në zyrën e përmbarruesit privat, ndërsa në shkresa të lëndës nuk ka prova që prapësimi është dorëzuar në ndonjërin nga mënyrat e tjera të përcaktuara për dërgimin e shkresave, rezulton se debitori prapësimin e ka paraqitur pas kalimit të afatit ligjor.

Dhoma e shkallës së dytë e Gjykatës Komerciale, i vlerësoi të gjitha pretendimet ankimore por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, sepse në asnjë rast debitori nuk ka provuar të dëshmojë se ka paraqit afatin për paraqitjen e prapësimi brenda afatit ligjor

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Dhoma e shkallës së dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pabazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbarrimore. Andaj me të drejtë Dhoma e shkallës së parë e ka hedhur poshtë si të pa afatshëm prapësimin e debitorit i ushtruar ndaj urdhrin përmbarrimor P.nr.068/22 të lejuar nga përmbarruesi privat me datën 02.03.2022.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika b) të LPK-së lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së dytë

K.Dh.Sh.II.nr.1190/23 datë 03.05.2024

Gjyqtari,
Krenar Berisha